




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
ËKomuna e Drenasit
Drejtoria për Administratë të Përgjithshme
Zyra e Prokurimit



KONTRATË /FURNIZIM/

Emri i Projektit: **FURNIZIM ME SWOTWER PËR DIGJITALIZER TË APARATIT TË RTG-së , KOMPJUTERË, MONITOR & UPS**

Numri identifikues: 611-18-172-136, Datë: 19/12/2018; Nr. i arkivit: 02 – 400 - 73942

PALËT NË MARRËVESHJE

KOMUNA E DRENASIT - Drenas, përfaqësuar nga MENSUR GLLAREVA Zyrtar i Prokurimit (më tutje "Punëdhënës").

" KosovaMed Healthcare " SH.P.K., 601670947 përfaqësuar nga KASTRIOT ASLLANI , Drejtor (më tutje kontraktuese).

Neni 1 Ligji i zbatushem

Neni 1 Ligji i aplikueshëm

1.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Ligjet Nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjet Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridikioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 2 Lënda

Lënda e kontratës duhet të jetë : FURNIZIM ME SWOTWER PËR DIGJITALIZER TË APARATIT TË RTG-së , KOMPJUTERË, MONITOR & UPS

Kontraktuesi duhet të jetë në pajtueshmëri të plotë me afatet e Kushteve të kontratës dhe të aneksit teknik, duke përfshirë të gjitha ndryshimet në variantin e propozuar.

2.1 Vendi i pranimit të punëve/shërbimeve / furnizimeve do të jetë: QKMF- DRENAS,

2.2 Inkotermi i zbatueshëm do të jetë DDP¹. Periudha e kryrjes se punëve/shërbimeve dhe furnizimeve do të jetë në afatin prej : 5 ditëve.

Neni 3 Çmimi

Çmimi i shërbimeve është në shumën prej: **7.190,00 €** (Shtatëmijë e Njëqind e Nentëdhjetë euro)

3.1 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas bersës përkatëse)

3.2 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e kontratës.

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Pagesa do të kryhet çdo herë kur raporton Organin mbikqyrës, duke mos e tejkaluar shumën prej: **7.190,00 €**

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

4.3 ZKA duhet të caktojë Menaxherin, ndërsa Komisionin për pranim i caktojnë ZKA apo Njësit kërkuese. Afati i kryerjes së punëve/shërbimeve/furnizimeve duhet të jetë brenda 5 diteve. Pranimi duhet të kryhet konform neneve të kontratës dhe duhet të jetë konform Pjesës IV, Nenit 81, pika 1, 2 dhe 3 të Ligjit mbi Prokurim Publik Nr. 04/L-042 dhe dokumentacionit dytësor. Monitorimin e kësaj kontrate dhe pjesët e Planit të Menaxhimit e kryen Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenje Sociale.

- a) Të gjitha pagesat kryhen në euro, pasi të dorëzohen dokumentat më të domosdoshme për pagesë tek Zyrtari për pagesë dhe arkivim. Përqindja % e pagesës, të punëve/shërbimeve dhe furnizimeve të kryera do të caktohet nga Menaxheri. Poashtu zyrtari për pagesë para se të kryhet pagesa duhet të bindet se fatura është konform kërkesës dhe çmimorës që është pjesë e kontratës. Çdo faturë duhet të pranohet nga Organi Mbikqyrës.
- b) Të gjitha dokumentet si: aktvendimet, procesverbalet, raportet për punëve/shërbimeve/ furnizimeve të kryera, saturat, shkresat, etj. duhet të dorëzohen tek Zyrtari për pagesë.
- c) Zyrtari për pagesë dhe arkivim të lëndëve, obligohet që të gjitha dokumentat rreth pagesave duke përfshirë edhe raportet e pranimit, urdhërit për pagesë dhe urdhërblerjes, t'i arkivoj dhe ruaj. Poashtu obligohet që dokumentet e kërkua nga auditorët për auditim ose nga palët shtetërore të interesuara t'ju ofroj sa herë që ata kanë nevojë.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i furnizimeve/shërbimeve/punëve duhet në të gjitha aspektet të plotësor specifikit teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit (Instalimi i Softweerit, full access, qasje në password, opçione shtesë nëse shfaqet nevoja nga prodhuesi i paisjes ekzistuese në radiologji CR IR 392 adv. Console dhe CD-ja në të cilën është përfshirë programi me Licencë) dhe në pajtim me rekonditimet e Menaxherit të caktuar nga ZKA dhe Drejtoria per Shendetësi.

Neni 7 Garancioni i furnizimeve

7.1 Përidha garantuese për eliminimin e të metave do te jetë: 1 (një) vit e cila është mbuluar me Deklaratë me shkrim nga OE .

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] [të realizojë ndonjë ose te gjitha shërbimet] [te kryej ndonjë ose te gjitha punët] brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së [furnizimeve] [punëve] [shërbimeve] të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori

Ekonomin i beson kryerjen ë ë një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e res-judikata; g) Operatori ekonomik i është nënshtuar një gjykimi që ka forcën e res judicata për mashtrim, korrasjon, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjeter ilegal që i dëmon ton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjeter ligjore që i pengon realizimin të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimesh nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsy që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.



13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në në pajtim me ligjin e Kosovës, Juridikioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin ei identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhen Shqipe në tri origjinalë, dy origjinalë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Pjesë e ofertës është paramasa dhe paralogaria e ofertuesit. Kontrata hynë në fuqi me **20/12/2018**.

Për Autoritetin Kontraktues		Për Kontraktuesin	
Emri:	MENSUR GLLAREVA	Emri:	KASTRIOT ASLLANI
Pozita:	ZPP	Pozita:	DREJTOR
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	20/12/2018	Data:	20/12/2018
Vula:		Vula:	 Prishtine - 601670947

PJESA C: FORMULARI I PARAQITJES SË KUOTIMIT TË ÇMIMIT

Seksioni I. Formulari i KUOTIMIT TË ÇMIMIT

Për: **KOMUNA GLLOGOC** (më tej "Autoriteti Kontraktues")

Titulli i Kontratës: FURNIZIM ME SOFTWER PËR DIGITALIZER TË APARATIT TË RTG-së , KOMPJUTERË, MONITOR & UPS

Në përgjigje të letrës suaj të ftësës për tender për kontratën e mësipërme, ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Ne kemi shqyrtuar dhe pranuar përbajtjen e plotë të dosjes së tenderit Nr **611-18-9335-1-3-6**. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësinë e tyre, pa rezervim ose kufizim.

2. Cmimi i përgjithshëm i kuotimit është:

Cmimi i përgjithshëm i kuotimit në shifra: [**7,190.00**] €

Dhe me shkrim [**SHTATE/NJË/NËNTË/ZERO/ZERO/ZERO** Euro]



3. Ky kuotim është i vlefshëm për një periudhë prej **[30 dite]** nga data përfundimtare për dorëzimin e kuotimit të çmimeve.

4. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Ne gjithashtu plotësish të njohim dhe pranojmë se ndonjë informacion të pasaktë ose të paplotë të dhënë me qëllim në këtë aplikacion mund të rezultojë në përjashtimin tonë nga kjo dhe kontrata të tjera të finançuara nga BKK.

5. Çmimi i përgjithshëm i kuotuar është fiks dhe nuk i nënshtrohet ndonjë ndryshimi gjatë kontratës (duke përjashtuar çmimet e këtyre artikujve që janë subjekt i rregullimeve të çmimeve në bazë të shkëmbimit të aksioneve përkatëse). Çmimi i përgjithshëm i kuotuar specifikohet dhe është i bashkangjitur në Specifikimet e Çmimit.

DORËZUAR NGA:

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK	
EMRI I KOMPANISE	KosovaMed Healthcare sh.p.k.
ADRESA E PLOTE	Rr.B (Kompleksi Royal), Muhamrem Fejza, Hyrja C15/13, Nr.4, Prishtinë, Republika e Kosovës
PERFAQESUAR NGA:	
EMRI	Kastriot Asllani
POZITA	Drejtor
NENSHKRIMI	
DATA	11.12.2018
VULA	